



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

3975

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Peshkopi, më 18.08.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për djepi Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.68

Datë 16.08.2022

“Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Qershor 2022, familjeve në nevojë që janë përjashtuar nga sistemi për arsye të plikëzimit, duke përdorur fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, I ndryshuar.”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Miki





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 68 Datë 16/08/2022

**“PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN QERSHOR 2022, FAMILJEVE NË NEVOJË QË JANË PËRJASHTUAR NGA SISTEMI PËR ARSYE TË PIKËZIMIT, DUKE PËRDORUR FONDIN E KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, I NDRYSHUAR”**


Në mbështetje të nimit 21, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 dhe VKM 957. Date 04.09.2019. “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, të Kreut IV, pika 2 të vendimit nr 955, date 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfutimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind”, i ndryshuar dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr 1190/1 prot, datë 23.02.2018 “Për përdorimin e fondit deri në 6%”, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **16.08.2022** miratoi me 20 vota pro 1 kundër 0 apstenim 6% e muajit Qershor 2022.

**VENDIM:**

1. Miratimin e dokumentacionit për dhënie e ndihmës ekonomike për muajin Qershor 2022 **463** familjeve në nevojë me fond **2.158.974** të cilat janë aplikuese në sistemin e nd.ekonomike, por nuk janë shpallur fituese.
2. Këto familje janë të përzgjedhura nga njësitë administrative sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.
3. I bashkangjitet këtij vendimi lista emërore me shumën përkatëse sipas Njësive Administrative.
4. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Sektori i Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Vendimi u shpall sot më datë **16.08.2022**.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava



Adresa: Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi, email: [bashkiadiber@gmail.com](mailto:bashkiadiber@gmail.com) tel:0035521822935



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.795/1.prot.

Peshkopi, më 22.08.2022

Lënda : Per vendimin nr. 68, datë 16.08.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISË DIBËR

PESHKOP I

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.68, date 16.08.2022 “Për dhënien e ndihmes ekonomike me fondin deri 6% për muajin qershor 2022”, konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehët për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje , veprim që kurdoherë është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturës së posaçme të Bashkisë Dibër që paraqet për miratim projekt akte të kësaj natyre.

Kemi shpjeguar disa herë se hyrja në fuqi e akteve administrative të kësaj natyre, bëhet sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 55/6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

P R E F E K T I  
Nexhbedin SHPEHU

